


SHKURT 2023

NGA SFIDAT E TEK ZGJIDHJET E PËRBASHKËTA



Peaceful
Change
Initiative

snipu Lajm

The background features a vertical grey bar on the left side. To the right of this bar, there is a large, dense cluster of 3D cubes in various shades of grey and white, creating a sense of depth and complexity. The cubes are arranged in a way that suggests a digital or architectural structure.

NGA SFIDAT E PËRBASHKËTA TEK ZGJIDHJET E PËRBASHKËTA

Hyrja dhe konteksti	7
Historiku dhe Metodologjia	9
Demografia	11
Rezultatet e hulumtimit	15
Konkluzionet	33

Ky studim është financuar nga PCI; megjithatë, pikëpamjet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmëri të qëndrimit zyrtar të PCI.

Hulumtimi i realizuar në kuadër të projektit “Nga sfidat e përbashkëta tek zgjidhjet e përbashkëta” kishte për qëllim të shqyrtojë problemet me të cilat ballafaqohen serbët në katër komunat që përbëjnë veriun e Kosovës dhe shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës (Serbia jugore). Të dy grupet zënë një hapësirë unike territoriale, sociale, kulturore dhe politike dhe përderisa ato, në kuptim më të gjerë, janë pakicë në Kosovë përkatësisht Serbi, përbëjnë shumicën ose pothuajse janë shumicë në rajonet e mbuluara nga ky hulumtim. Sidoqoftë, të dyja përballen me një sërë pengesash dhe sfidash specifike kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e tyre me organet qeverisëse të nivelit lokal dhe qendror, si dhe me navigimin nëpër të ardhmen e ekosistemit paskonfliktuoz që shpesh është i shënuar me periudha të zgjatura paqartësie dhe incidente sporadike të dhunës.

Pas pushimit të konflikteve të armatosura në Kosovë në vitin 1999 dhe kryengritjes në Luginën e Preshevës në vitin 2001, vendbanimet pasuese¹ çuan në një paqe shpesh të pasigurt dhe asnjëri prej tyre nuk arriti domosdoshmërisht të niste bashkëjetesën ose pajtimin afatgjatë ndëretnik. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013 shënoi një ndryshim të dukshëm për veriun e Kosovës, dhe solli ‘integrimin’ e strukturave institucionale, përkatësisht krijimin e administratave komunale (Mitrovica e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok) që funksionojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe kushtetuese të Kosovës. Përkundër kësaj, serbët e Kosovës kanë qenë subjekt i formave të ndryshme të diskriminimit të institucionalizuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për qasjen në shërbime, përdorimin e gjuhës, si dhe marrjen e dokumenteve të identifikimit.² Ngjashëm, siç tregojnë rezultatet e këtij hulumtimi, shqiptarët që jetojnë në jug të Serbisë gjithashtu përballen me barriera të shumta, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e tyre me strukturat qeverisëse të nivelit lokal dhe qendror.

Sikurse Serbia ashtu edhe Kosova kanë miratuar legjislacionin që komuniteteve joshumicë u njeh dhe u jep të drejta për të zhvilluar identitetin e tyre, për të përdorur gjuhët e tyre amtare (zyrtare dhe jozyrtare), për të mbrojtur trashëgiminë e tyre kulturore dhe ofruar mbrojtje ligjore ndaj praktikave diskriminuese.³ Në rastin e Kosovës, shtrirja dhe gjerësia e këtyre kornizave ligjore është më e madhe se sa në rastin e Serbisë, veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtat gjuhësore,⁴ pasi gjuhës serbe, sa i përket përdorimit të saj në nivel zyrtar i është dhënë (teorikisht) status i barabartë me gjuhën shqipe. Në Serbi, gjuhët e pakicave janë të mbrojtura nga *Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare*, dhe e njëjta është nënshkruese e *Kartës Evropiane të Gjuhëve Krahinore ose të Pakicave*, prandaj edhe përdorimi i gjuhëve të pakicave në zonat ku ato kanë një prani historike është i paraparë nga këto dy akte. Pavarësisht kësaj, në të dyja rastet, vërehet se zbatimi është më se i pamjaftueshëm, ku serbët në Kosovë dhe shqiptarët në Serbi raportojnë shkelje të gjera të legjislacionit përkatës që rregullon të drejtat gjuhësore, veçanërisht në sistemin gjyqësor.⁵

Prandaj, në rezultatet e hulumtimit cilësor të paraqitur në seksionet vijuese të këtij raporti mund edhe të vërehet se në jetën e përditshme të dyja këto komunitete përballen me një gamë të gjerë vështirësish në marrëdhëniet e tyre me organet qeverisëse, dhe në fakt në ushtrimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj.

¹ Konflikti në Kosovë rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës në qershor të vitit 1999 ndërsa kryengritja në Luginën e Preshevës u është ndërprerë me nënshkrimin e Marrëveshjes së Konçulit në vitin 2002.

² Shih: *Raporti vjetor rreth statusit të të drejtave të komuniteteve joshumicë në Kosovë*. OJQ AKTIV, Mitrovica e Veriut, 2022.

³ Në Kosovë, këto të drejta janë të garantuara me kushtetutë dhe rregullohen me një sërë aktesh legjislativë shtese zameniti sa plotësuese që përfshijnë, por nuk kufizohen në, Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për Trashëgiminë Kulturore. Në Serbi, Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave Kombëtare garanton gjithashtu të drejtën e pakicave për të ruajtur identitetin e tyre kulturor/etnik dhe, në nivel të qeverisjes lokale në disa komuna ku kanë prani historike ofrimin e shërbime në gjuhët e tyre amtare.

⁴ Kushtetuta dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve garantojnë teorikisht barazinë absolute të gjuhës serbe dhe shqipe në të gjitha nivelet e qeverisjes.

⁵ *Raport mbi Zbatimin e Kartës Evropiane të Gjuhëve Krahinore ose të Pakicave në Serbi*, 2013, fq. 24.

⁶ *Raporti vjetor rreth statusit të të drejtave të komuniteteve joshumicë në Kosovë*. OJQ AKTIV, Mitrovica e Veriut, 2022.

Historiku dhe Metodologjia

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit të zbatuar nga *Qendra për Demokraci dhe Edukim - Lugina* në Bujanoc dhe *DJQ AKTIV* në Mitrovicën e Veriut. Qëllimi kryesor është të bëhet një analizë krahasuese e pozitës së komunitetit serb në katër komunat veriore të Kosovës dhe komunitetit shqiptar në jug të Serbisë. Më konkretisht, synimi ishte realizimi i një hulumtimi të opinionit publik (sasior) që do të fokusohet në sfidat kryesore që ndajnë të dy komunitetet përkatëse dhe hartimi i sërë rekomandimesh për veprime të mëtejshme drejtuar pushtetit lokal dhe qendror, komunitetit ndërkombëtar, si dhe mediave dhe shoqërisë civile.

Hulumtimi shqyrtoi fushat e mëposhtme:

- Integrimi, pjesëmarrja dhe komunikimi i qytetarëve me qeverisë lokale dhe qendrore
- Liria e lëvizjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (dokumentet personale dhe targat e veturave)
- Përdorimi i gjuhëve
- Perspektiva e të rinjve

Zhvillimi i metodave të kombinuara kërkimore (sasiorë dhe cilësorë) dhe analizave krahasuese kishte për qëllim gjenerimin e të dhënave sa më të sakta për problemet me të cilat ballafaqohen shqiptarët në jug të Serbisë dhe serbët në veri të Kosovës.

The background features a vertical gray bar on the left side. To the right of this bar, there is a large, dense cluster of 3D cubes in various shades of gray, creating a textured, isometric effect. The cubes are arranged in a way that suggests depth and volume, with some cubes appearing to be stacked on top of others.

Demografia

Gjinia:

Lugina e Preshevës

51.9%

53.7%

Veriu i Kosovës

GRA



BURRA

Lugina e Preshevës

48.1%

46.3%

Veriu i Kosovës

Mosha mesatare e të anketuarve: Lugina e Preshevës dhe Veriu i Kosovës – 40 vjeç

Niveli i arsimit:



Lugina
e Preshevës

Fillor	21.7%
I mesëm	32.1%
Shkolla e lartë	15.7%
Fakulteti	30.5%



Veriu i Kosovës

Fillor	2.4%
I mesëm	44%
Shkolla e lartë	18%
Fakulteti	35.6%

Statusi juaj i punësimit:

● Lugina e Preshevës

● Veriu i Kosovës

I/e punësuar në sektorin publik në institucionet serbe

8%

32.1%

I/e punësuar në sektorin publik në institucionet kosovare

5.1%

8%

I/e punësuar në sektorin privat

2.7%

9.5%

I/e vetëpunësuar/kam biznesin tim

15.7%

6.1%

I/e papunë

50.1%

21.1%

Student/e apo nxënës/e i/e shkollës së mesme

2.4%

11.9%

I/e punësuar në sektorin jofitimprurës (OJQ)

8%

4%

Pensionist/e

8%

7.3%

Vendbanimi:



Lugina e Preshevës

Preshevë	46.9%
Bujanoc	46.4%
Medvegjë	6.7%



Veriu i Kosovës

Mitrovica e Veriut	34.7%
Leposaviq	24.2%
Zveçan	24.5%
Zubin Potok	16.6%

Lloji i vendbanimit

37.6%


62.4%



Lugina e Preshevës

68.5%

31.5%



Veriu i Kosovës

- Urban (qytet)
- Rural (fshat)

The background features a vertical gray bar on the left side. To the right of this bar, there is a large, dense cluster of 3D cubes of varying shades of gray, creating a textured, isometric effect. The cubes are arranged in a way that suggests depth and volume, with some appearing to float or be stacked.


Rezultatet e hulumtimit

Nga cilat media informoheni më shpesh?



Analiza tregon se të anketuarit nga Lugina e Preshevës në krahasim me të anketuarit nga veriu i Kosovës informohen më shumë përmes mediave tradicionale dhe rrjeteve sociale, ndërsa të anketuarit nga veriu i Kosovës, në krahasim me ata të anketuarit nga jugu i Serbisë, më shumë informohen përmes portaleve online të shtëpive mediatike.

2 Në përgjithësi, kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtave të komunitetit shqiptar në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës nga ana e institucioneve / respektimin e të drejtave të komunitetit serb në veri të Kosovës nga ana e institucioneve (në nivel lokal dhe qendror), me cilat probleme/pengesa jeni ballafaquar më shpesh?




Shënoni sugjerimin tuaj

/

Kadastër; Shërbime jo të mira të institucioneve


Sa i përket respektimit të të drejtave, siç është refuzimi për të ofruar shërbime publike dhe mungesa e formularëve/dokumentacionit të shkruar në gjuhën amtare nuk ka dallime domethënëse ndërmjet të anketuarve nga Lugina e Preshevës dhe veriu i Kosovës. Megjithatë, vërehet se të drejtat e komunitetit serb në veri të Kosovës më shpesh shkelen kur bëhet fjalë për mosrespektimin e të drejtës së përdorimit të gjuhës amtare në institucione në formë gojore.

Personalisht, a mendoni se qasja në informacion dhe shërbime publike në gjuhën tuaj amtare respektohet në nivel lokal dhe a jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga institucionet vendore?




Të anketuarit nga Lugina e Preshevës në një masë dukshëm më të madhe se të anketuarit nga veriu i Kosovës besojnë se ligjet që garantojnë qasje në informata dhe shërbime publike në gjuhën amtare nuk respektohen në nivel lokal.

Cfarë dokumente identifikimi (letërnjoftim dhe/ose pasaportë) personalisht posedoni?




Rezultatet e hulumtimit kur bëhet fjalë për dokumentet e identifikimit tregojnë një dallim specifik ndërmjet të anketuarve nga Lugina e Preshevës dhe veriu i Kosovës. Gjegjësisht, të anketuarit nga Lugina e Preshevës kryesisht posedojnë dokumente të lëshuara nga institucionet e Republikës së Serbisë. Në anën tjetër, të anketuarit nga veriu i Kosovës posedojnë kryesisht dokumente të lëshuara nga institucionet serbe dhe ato të Kosovës. Megjithatë, çdo i katërti i anketuar nga veriu i Kosovës ka vetëm dokumente serbe.

5 Sa i përket qasjes në dokumente serbe / dokumente kosovare, a keni hasur në ndonjë problem gjatë aplikimit dhe/ose lëshimit të tyre?




Të dhënat tregojnë se të anketuarit nga jugu i Serbisë gjatë aplikimit për dokumente serbe shumë më rrallë kanë hasur në probleme, se sa të anketuarit nga veriu i Kosovës gjatë aplikimit për dokumente në institucionet kosovare.. Vërehet se çdo i pesti i anketuar nga veriu i Kosovës nuk ka aplikuar për dokumente kosovare, ndërsa në anën tjetër, një numër shumë i vogël i të anketuarve nga jugu i Serbisë nuk ka aplikuar për dokumente serbe.

6 Sipas mendimit tuaj cili është problemi më i madh në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës/ në komunat në veri të Kosovës?




Problem më të madh për të anketuarit nga Lugina e Preshevës paraqesin (1) gjendja ekonomike dhe papunësia, (2) migrimi dhe largimi i të rinjve dhe (3) nostrifikimi i diplomave. Në anën tjetër, për të anketuarit nga veriu i Kosovës, problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen janë (1) siguria e cënvar, (2) krimi dhe korrupsioni dhe (3) paqëndrueshmëria politike/gjendja ekonomike dhe papunësia/ migrimi dhe largimi i të rinjve (këto tre probleme kanë frekuencë pothuajse të njëjtë).

7 Sipas mendimit tuaj, jeta për shqiptarët në jug Luginë të Preshevës / jeta për serbët në veri të Kosovës në tre vite do të jetë:



Të dhënat e marra nga analiza krahasuese tregojnë një pesimizëm të theksuar kur bëhet fjalë për cilësinë e jetës në të ardhmen e afërt si në veri të Kosovës ashtu edhe në Luginë të Preshevës. Të anketuarit nga veriu i Kosovës besojnë dukshëm më shumë se të anketuarit nga Lugina e Preshevës se jeta për serbët në veri të Kosovës do të jetë më e keqe në tre vitet e ardhshme. Këtë qëndrim në mesin e të anketuarve në veri të Kosovës e ndajnë 7 nga 10 të anketuar. Nga ana tjetër, 6 nga 10 të anketuar nga jugu i Serbisë besojnë se jeta për shqiptarët në jug të Serbisë do të jetë më e keqe në tre vitet e ardhshme.

Pyetje për të rinjtë (nga 18 deri në 29 vjeç): A e shihni të ardhmen tuaj (në tre vitet e ardhshme) në Serbi/ në Kosovë?



Pasojat e pesimizmit dhe mungesës së besimit për cilësi më të mirë të jetës në të dyja mjediset (në Luginë të Preshevës dhe veri të Kosovës), për rrjedhojë tek të rinjtë e anketuar kanë rritjen e motivit për migrim. Të anketuarit në veri të Kosovës pak më shumë se të anketuarit në Luginë të Preshevës mendojnë se në tre vitet e ardhshme do të largohen nga vendi/shteti ku jetojnë.

9 Nënpyetje për të rinjtë (nga 18 deri në 29 vjeç): Cilat janë parakushtet që duhet të përmbushen që të vendosni të qëndroni dhe të ndërtoni të ardhmen në Serbi / në Kosovë?

	Lugina e Preshevës	Veriu i Kosovës
Situata e përmirësuar e sigurisë në nivel lokal	28.7%	37.4%
Integrimi i plotë i shqiptarëve në sistemin serb	14.7%	1%
Përmirësimi i dukshëm i situatës ekonomike në nivel lokal (nëpërmjet investimeve publike)	31.7%	42.4%
Integrimi i Luginjës së Preshevës në Kosovë (në formën e shkëmbimit të territoreve)	21%	6.1%
Ulja drastike e korrupsionit dhe nepotizmit në punën dhe funksionimin e institucioneve lokale	31.1%	42.4%
Ulja e dukshme e ndikimit të retorikës nacionaliste në paraqitjet e politikanëve dhe akterëve të shoqërisë	15.3%	19.2%
Arritja e një marrëveshjeje përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës	26.3%	26.3%
Tjetër	Lugina e Preshevës /	Veriu i Kosovës Ulja e krimit; Më shumë mundësi punësi- mi; Respektimi i të drejtave

Parakushtet më të rëndësishme për të qëndruar në Serbi për të rinjtë e anketuar nga Lugina e Preshevës janë (1) përmirësimi i dukshëm i situatës ekonomike në nivel lokal (përmes investimeve publike), (2) ulja drastike e korrupsionit dhe nepotizmit në punën dhe funksionimin e institucioneve lokale dhe (3) situata e përmirësuar e sigurisë në nivel lokal. Për të rinjtë e intervistuar nga veriu i Kosovës, parakushtet më të rëndësishme për të qëndruar në Kosovë janë (1) ulja drastike e korrupsionit dhe nepotizmit në punën dhe funksionimin e institucioneve lokale, (2) përmirësimi i dukshëm i situatës ekonomike në nivel lokal (përmes investimeve publike) dhe (3) situata e përmirësuar e sigurisë në nivel lokal. Për të dy grupet e të rinjve, arritja e një marrëveshjeje përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës renditet në vendin e katërt për nga rëndësia.

Sipas mendimit tuaj cilat parakushte duhet të plotësohen për të përmirësuar gjendjen ekonomike në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës/ komunat në veri të Kosovës?


	Lugina e Preshevës	Veriu i Kosovës
Punë më transparente dhe më llogaridhënëse e institucioneve dhe individëve të punësuar në to	27.2%	38.7%
Luftë më efikase kundër korrupsionit dhe nepotizmit	49.7%	68.4%
Rritje e investimeve publike në nivel lokal	19.1%	19.3%
Ndihmë financiare për ndërmarrësit privatë në nivel lokal	13.7%	20.9%
Procedura të lehtësuara gjatë të bërit biznes	13.9%	21.1%
Mjedis më cilësorë i sigurisë	16.9%	34.6%
Hartim i një plani të vetëqeverisjes lokale për zhvillim ekonomik afatgjatë	12.4%	30.4%
Zbatim më adekuat i procesit të integrimit institucional	10.4%	4.9%
Angazhim më i qartë i vendimmarrësve në nivel qendror për përmirësimin e kushteve ekonomike në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës	35.9%	19.3%
Tjetër:	Lugina e Preshevës	Veriu i Kosovës
	Hapja e fabrikave	Më shumë investime nga Serbia; Më shumë mundësi punësimi
Asnjë nga përgjigjet e ofruara	1.2%	4.3%

Si parakushtet më të rëndësishme që mund të çojnë në përmirësim të gjendjes ekonomike në Luginë të Preshevës, të anketuarit identifikuan (1) luftën më efikase kundër korrupsionit dhe nepotizmit, (2) angazhimin më të qartë të vendimmarrësve në nivel qendror për përmirësimin e kushteve ekonomike në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe (3) punën më transparente dhe më llogaridhënëse të institucioneve dhe individëve të punësuar në to. Në anën tjetër, të anketuarit nga veriu i Kosovës, si parakushte më të rëndësishme që mund të çojnë në përmirësimin e gjendjes ekonomike në veri të Kosovës theksojnë (1) luftën më efikase kundër korrupsionit dhe nepotizmit, (2) punën më transparente dhe më llogaridhënëse të institucioneve dhe individëve të punësuar në to dhe (3) mjedisin më cilësorë të sigurisë.

Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është “jashtëzakonisht të këqija” dhe 5 është “të shkëlqyeshme”, vlerësoni gjendjen aktuale të marrëdhënieve ndëretnike në mes të komuniteteve në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës / komuniteteve në komunat në veri të Kosovës?


Lugina e Preshevës

- Shqiptarë dhe serbë
- Shqiptarë dhe kombësi tjera në mjedisin tuaj lokal



Veriu i Kosovës


- Serbë dhe shqiptarë
- Serbë dhe kombësi tjera në mjedisin tuaj lokal




Të dhënat e hulumtimit tregojnë se të anketuarit nga veriu i Kosovës i vlerësojnë marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, si dhe serbëve dhe kombësive të tjera si më të mira, sesa që të anketuarit nga Lugina e Preshevës i vlerësojnë marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, si dhe shqiptarëve dhe kombësive të tjera. Dallimi është veçanërisht i theksuar kur janë në pyetje marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve me pjesëtarët e kombësive tjera, ku shihet se marrëdhëniet e serbëve me kombësi tjera në veri të Kosovës janë vlerësuar më mirë (57.8%) në krahasim me marrëdhëniet e shqiptarëve me kombësi tjera në Luginë të Preshevës (34%).

Në tabelën para jush janë shtatë lloje të ndryshme kontaktesh që mund të realizoni me pjesëtarë të kombësisë serbe / të kombësisë shqiptare. Ju lutemi, përgjigjuni në secilën prej tyre bazuar në përshtypjen tuaj të parë. Përgjigjuni me PO ose JO.

A do ta pranonit që një pjesëtar i kombësisë serbe/kombësisë shqiptare të:




Shkalla nga 0 deri në 7




Vështrimet nga hulumtimi tregojnë distancë më të theksuar etnike në mesin e të anketuarve në Luginë të Preshevës sesa në mesin e të anketuarve në veri të Kosovës. Ka pothuajse gjashtë herë më shumë të anketuar pa distancë etnike në veri të Kosovës sesa në Luginë të Preshevës. Gjithashtu, pothuajse çdo i dyti i anketuar tjetër në veri të Kosovës ka një distancë etnike me intensitet të ulët. Në anën tjetër, 7 nga 10 të anketuar në Luginë të Preshevës kanë shkallë të lartë të distancës etnike, krahasuar me çdo të katërt të anketuar nga veriu i Kosovës.

13 Sa jeni në dijeni për Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes dhe zbatimin e saj (përdorimin e dokumenteve të udhëtimit, dokumenteve të udhëtimit për të mitur, patentë shoferit etj.)?



Sipas të gjeturave të hulumtimit, duket se nuk ka dallime të mëdha rreth informimit mbi Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes dhe zbatimin e saj, edhe pse vërehet se disi më pak në dijeni të Marrëveshjes janë të anketuarit nga veriu i Kosovës.

1 A ndikoi dhe në çfarë mase vendosja e regjimit të afisheve (stikerëve) në lirinë e lëvizjes, duke e krahasuar atë me periudhën e mëparshme (pa stiker)?



Të anketuarit nga Lugina e Preshevës dhe veriu i Kosovës ndajnë mendimin se vendosja e regjimit të afisheve e ka vështirësuar lirinë e lëvizjes. Këtë pikëpamje ndajnë gjithsej 7 nga 10 të anketuar nga Lugina e Preshevës dhe 6 nga 10 të anketuar nga veriu i Kosovës.

1 Vitin e fundit, kur keni udhëtuar nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas, a jeni ekspozuar ndaj ndonjë situatë të pakëndshme (të shkaktuar nga organet e rendit) apo a ju është pamundësuar kalimi?

- Nuk kam përjetuar asnjë shqetësim **89%**
- Kam përjetuar shqetësim **2.6%**
 - Për shkak të dokumenteve; Për shkak të vaksinës kundër Covid-19; Kontroll i detajuar i personave dhe bagazheve
- Më është pamundësuar kalimi **2.8%**
- Tjetër: Certifikatë për vaksinimin kundër Covid-19; Pa dokument identifikimi **1.2%**
- Nuk kam udhëtuar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë **4.4%**



- Nuk kam përjetuar asnjë shqetësim **55%**
- Kam përjetuar shqetësim **14.1%**
 - Probleme me afishe; Trajtimi i keq nga policia
- Më është pamundësuar kalimi **10.7%**
- Tjetër: Certifikatë për vaksinimin kundër Covid-19; Pa dokument identifikimi **0%**
- Nuk kam udhëtuar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë **20.2%**



Të dhënat tregojnë se një numër dukshëm më i madh i të anketuarve nga veriu i Kosovës ishin në situatë të pakëndshme gjatë udhëtimit (Kosovë-Serbi) në krahasim me të anketuarit nga Lugina e Preshevës. Gjithashtu, shumë më shpesh iu është pamundësuar kalimi të anketuarve nga veriu i Kosovës sesa të anketuarve nga Lugina e Preshevës. Të dhënat tregojnë gjithashtu se çdo i pesti i anketuar nga veriu i Kosovës në vitin e fundit nuk ka udhëtuar në Serbi.

Sipas mendimit tuaj cilët janë faktorët që ndikojnë në perceptimin tuaj për cenimin e sigurisë personale në nivel lokal?


	Lugina e Preshevës	Veriu i Kosovës
Retorika nxitëse/nacionaliste e politikanëve (vendimmarrësve) dhe akterëve të shquar të shoqërisë	46.3%	48.6%
Incidentet e sigurisë/ndëretnike në Kosovë dhe/ose Serbi	15.3%	63.3%
Lëvizjet e paligjshme migruese në nivel lokal	12.7%	5.8%
Pasojat e vendimeve të marra në kuadër të procesit të bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës	22.7%	45.6%
Fatkeqësitë natyrore	13.2%	1.8%
Paqëndrueshmëria politike në Kosovë dhe/ose Serbi	24.4%	38.2%
Titujt e mediave në të cilat pjesëtarët e komunitetit tuaj etiketohen në mënyrë fyese	14.5%	30%
Tjetër	Lugina e Preshevës /	Veriu i Kosovës Sjellja e policisë
Asnjë nga përgjigjet e ofruara	1.5%	5.8%

Perceptimi i kërcënimeve ndaj sigurisë personale në nivel lokal në mesin e të anketuarve në Luginë të Preshevës është më i ndikuar nga (1) retorika nxitëse/nacionaliste e politikanëve (vendimmarrësve) dhe akterëve të shquar të shoqërisë, (2) paqëndrueshmëria politike në Kosovë dhe/ose Serbi dhe (3) pasojat e vendimeve të marra në kuadër të procesit të bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

Në anën tjetër, perceptimi i kërcënimeve ndaj sigurisë personale në nivel lokal në mesin e të anketuarve në veri të Kosovës është më i ndikuar nga (1) incidentet e sigurisë/ndëretnike në Kosovë dhe/ose Serbi, (2) retorika nxitëse/nacionaliste e politikanëve (vendimmarrësve) dhe akterëve të shquar të shoqërisë dhe (3) pasojat e vendimeve të marra në kuadër të procesit të bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

17 IA mendoni se përfaqësuesit politikë të shqiptarëve nga jugu i Serbisë / përfaqësuesit politikë të serbëve nga Kosova (veriu) duhet të marrin pjesë dhe të përfaqësohen drejtpërdrejt në bisedimet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës?


- Po
- Jo
- Nuk jam i/e sigurt



Të anketuarit nga Lugina e Preshevës dhe veriu i Kosovës ndajnë mendimin se përfaqësuesit politikë nga zonat e tyre lokale duhet drejtpërdrejt të marrin pjesë dhe të përfaqësohen në bisedime ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Vërehet se përfaqësimi i këtij qëndrimi është disi më i shpeshtë tek të anketuarit nga veriu i Kosovës.

18 Në çfarë mënyre njohja reciproke e diplomave (verifikimi/nostrifikimi i diplomave) të marra në Kosovë / në sistemin arsimor serb do ta lehtësonte procesin e punësimit dhe mobilitetit profesional brenda dhe jashtë Serbisë / Kosovës?

- Plotësisht do ta lehtësonte
- Pjesërisht do ta lehtësonte
- Nuk do ta lehtësonte
- Nuk kam qëndrim



Analiza krahasuese e përgjigjeve në këtë pyetje tregon një interes dhe nevojë më të madhe të të anketuarve nga Lugina e Preshevës për zgjidhjen e problemit të nostrifikimit të diplomave. Pothuajse çdo i anketuar nga jugu i Serbisë deklaroi se zgjidhja e problemit të nostrifikimit të diplomave do të lehtësonte procesin e punësimit dhe mobilitetit profesional. Në anën tjetër, 43.4% e të anketuarve nga veriu i Kosovës e ndajnë këtë mendim, por edhe 40% e të anketuarve nga veriu i Kosovës nuk kanë qëndrim të zhvilluar për këtë çështje.

Te cilat nga figurat socio-politike të ofruara në listë keni më shumë besim?

	Lugina e Preshevës	Veriu i Kosovës
Qeveria e Kosovës	64.3%	1.2%
Qeveria e Serbisë	8.3%	21.8%
Presidentja e Kosovës	37.3%	0.6%
Presidenti i Serbisë	6.3%	17.7%
Trupi koordinues për jugun e Serbisë / Zyra për Kosovë dhe Metohi	12.5%	4.9%
Kryetari i komunës suaj në jug të Serbisë/ në veri të Kosovës	13.2%	1.5%
Koalicionet e shqiptarëve të Luginës dhe/ose Alternativa për Ndryshim / Lista serbe	21.7%	2.4%
Akterët politik të opozitës	1.2%	1.8%
Mediat në gjuhën serbe	2.7%	2.8%
Mediat në gjuhën shqipe	17.5%	0.3%
Organizatrat joqeveritare lokale	0.3%	11.6%
Asnjë nga përgjigjet e ofruara	0.5%	50.8%

Të anketuarit nga Lugina e Preshevës (jugu i Serbisë) kanë besimin më të madh në (1) Qeverinë e Kosovës, (2) Presidenten e Kosovës dhe (3) mediat në gjuhën shqipe. Në anën tjetër, të anketuarit nga veriu i Kosovës kanë besimin më të madh në (1) Qeverinë e Serbisë, (2) Presidentin e Serbisë dhe (3) organizatat joqeveritare lokale. Është veçanërisht e rëndësishme që çdo i dyti i anketuar nga veriu i Kosovës ka deklaruar se nuk i beson asnjërit prej institucioneve të ofruara.

20 Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është “nuk besoj fare” dhe 5 është “besoj plotësisht”, sa besoni në:

Lugina e Preshevës

Komisionin Republikan të Zgjedhjeve – MESATARJA 2.59



Policinë – MESATARJA 2.66



Organet e drejtësisë – MESATARJA 2.6



Avokatin e popullit (Ombudspersonin) – MESATARJA 2.74



● 1 ● 2 ● 3 ● 4 ● 5

Veriu i Kosovës

Komisionin Republikan të Zgjedhjeve – MESATARJA 1.72

3.4% 0.9%



Policinë – MESATARJA 1.67

1.8% 0.3%



Organet e drejtësisë – MESATARJA 1.94

3.4% 1.3%



Avokatin e popullit (Ombudspersonin) – MESATARJA 2.2

1.9%



● 1 ● 2 ● 3 ● 4 ● 5

Kur bëhet fjalë për institucionet e cekura, hulumtimi tregon se të anketuarit nga Lugina e Preshevës kanë shkallë më të lartë besimi se të anketuarit nga veriu i Kosovës. Të anketuarit nga Lugina e Preshevës, si dhe të anketuarit nga veriu i Kosovës, më së shumti kanë besim në Avokatin e popullit (Ombudspersonin). Të anketuarit nga Lugina e Preshevës kanë më së paku besim në Komisionin Republikan të Zgjedhjeve, ndërsa të anketuarit nga veriu i Kosovës në policinë.

Ne iistën e ofruar të subjekteve ndërkombëtare, në cilin keni më shumë besim kur bëhet fjalë për promovimin (potencial) dhe avancimin e të drejtave të komunitetit tuaj?


Lugina e Preshevës	
Bashkimi Evropian (BE)	35.2%
SHBA	67%
OSBE (OSCE)	7.9%
Kombet e Bashkuara (OKB)	9.3%
NATO	47.5%
Tjetër	/
Asnjë nga përgjigjet e ofruara	0.5%

Veriu i Kosovës	
Bashkimi Evropian (BE)	7.4%
SHBA	9.8%
OSBE (OSCE)	2.1%
Kombet e Bashkuara (OKB)	20.5%
NATO	3.7%
Tjetër	KEOR dhe Rusia
Asnjë nga përgjigjet e ofruara	56.7%

Të anketuarit nga Lugina e Preshevës kanë besimin më të madh në (1) SHBA, (2) BE dhe (3) NATO. Në anën tjetër, të anketuarit nga veriu i Kosovës kanë besimin më të madh në (1) OKB (2) SHBA dhe (3) BE. Megjithatë, dallimet në shkallën e besimit janë shumë të mëdha, sidomos kur bëhet fjalë për besimin në SHBA, NATO dhe BE. Po ashtu, pothuajse 60% e të anketuarve nga veriu i Kosovës deklarojnë se nuk i besojnë asnjërit prej akterëve të ofruar.

Cili nga skenarët e ofruar për një marrëveshje të mundshme gjithëpërfshirëse ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës do të ishte më i pranueshëm për komunitetin shqiptar në jug të Serbisë?/ për komunitetin serb në veri të Kosovës?

● Lugina e Preshevës ● Veriu i Kosovës



Kur bëhet fjalë për skenarët e mundshëm të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, vërejmë dallime domethënëse ndërmjet të anketuarve nga Lugina e Preshevës dhe veriu i Kosovës. Para së gjithash, të anketuarit nga veriu i Kosovës në masën më të madhe refuzojnë ndonjë nga përgjigjet e ofruara, e përveç kësaj, i vetmi skenar me përqindje dyshifrore të mbështetjes është ruajtja e statusit aktual (status quo). Në anën tjetër, të anketuarit nga Lugina e Preshevës më së shumti mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Beogradi zyrtar. Gjithashtu, çdo i katërti i anketuar nga Lugina e Preshevës (jugu i Serbisë) mbështet skenarin që nënkupton shkëmbimin e territoreve (veriu i Kosovës për Luginën e Preshevës). Një përqindje e vogël e të anketuarve nga Lugina e Preshevës (jugu i Serbisë) e mbështet atë të status quos.

Nga këto rezultate mund të konkludohet se serbët në veri të Kosovës dhe shqiptarët në Luginë të Preshevës e shohin veten me një sërë problemesh të përbashkëta – me përjashtim shumë të dukshëm të sigurisë dhe mbrojtjes, që, ndoshta për arsye të kuptueshme, është një çështje që shqetëson shumë më tepër serbët në veri të Kosovës. Një numër i ngjashëm (rreth 40%) i të anketuarve nga secili grup raportuan personalisht probleme në marrjen e shërbimeve personale ose informacionit (të shkruar) në gjuhën e tyre amtare, gjë që tregon për probleme më të mëdha dhe më të thella institucionale në sigurimin e zbatimit të ligjeve që rregullojnë të drejtat e komuniteteve joshumicë. Interesant është edhe fakti që duket se ka një pesimizëm të përhapur kur bëhet fjalë për mirëqenien materiale, çështjet ekonomike dhe perspektivat e punësimit. Në fakt, një përqindje e madhe e të anketuarve nga të dy komunitetet theksuan papunësinë dhe emigrimin si disa nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen. Kjo ka krijuar një ndjenjë apatie, zhgënjimi dhe mosbesimi ndaj akterëve institucionalë dhe politikë, si dhe një besim të përhapur se, në përgjithësi, gjatë viteve të ardhshme kushtet e jetesës do të përkeqësohen. Për më tepër, distanca etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve (si në Serbi ashtu edhe në Kosovë) është ende e dukshme, por ndoshta mund të shihet si një pikë e ndritur, në kuptim që një numër relativisht i madh i të anketuarve kanë sinjalizuar për tolerancë sa i përket lidhjeve personale me pjesëtarët e grupit tjetër.

Çështja kyçe, sa i përket hartimit të politikave, është se deri në çfarë mase merren parasysh shqetësimet e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe nëse përfaqësuesit e tyre politikë i kanë apo jo të artikuluar nevojat kolektive në një mënyrë që mund të çojë në ndryshime të prekshme (pozitive) të kushteve aktuale të jetesës. Në këtë kuptim, duket se ka një pakënaqësi të përbashkët rreth drejtimit të përgjithshëm të zhvillimeve socio-politike, që kryesisht mund të jetë rezultat i mungesës së përfshirjes dhe angazhimit aktiv në procese (siç është procesi i dialogut, kur flitet për serbët e Kosovës) që kanë ndikim të rëndësishëm në jetesën e tyre. Kështu, duke marrë parasysh shqetësimet dhe problemet e përbashkëta, një lidhje më e fortë e komuniteteve në Luginë të Preshevës dhe në veri të Kosovës do të ishte më e dobishme në krijimin e të kanaleve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, si dhe ngritjes së nivelit të mirëkuptimit mes tyre.

